

## KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI

# NJOFTIM PER INFORMATA SHTESE

ose

## PERMIRESIM I GABIMIT

Sipas Nenit 53 të Ligjit Nr. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92

Punë

Furnizim

Shërbime

[Përkujtese: Nëse ndonjë përmirësim i gabimit ose informacion shtese shpije ne një ndryshim rrënjësor të kushteve të parashikuara në njoftimin origjinal te kontratës me një influencë mbi parimin e trajtimit të barabartë dhe në objektivin e prokurimit konkurrues, do të jetë e nevojshme zgjatja e afateve fillimisht te parapara ]

Data e përgatitjes te këtij njoftimi: 25.09.2024

Nr i Prokurimit	621-24-9894-5-2-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



### NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

#### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI		
Adresa Postare: DRAGASH		
Qyteti: DRAGASH	Kodi postar: -	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Nuro Ismaili		Telefoni: 038-200-45509
Email: nuro.ismaili@yahoo.com		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		<a href="http://kk.rks-gov.net/dragash/">http://kk.rks-gov.net/dragash/</a>

### NENI II: LËNDA E KONTRATËS

#### II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

•102•Asfaltimi i rrugës Kapre-Rrenc (vazhdimi) (projekt dy vjeçar)

**II.1.2) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës** (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

■ asfaltimi i rrugës Kapre-Rrenc – L=2100m’ ■ si dhe elemente tjera të specifikuara në dosjen e tenderit

**II.1.3) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):** (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

45000000-7

### NENI III: PROCEDURA

#### III.1) LLOJI I PROCEDURËS

**III.1.1) Lloji i procedurës** (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

E hapur

E kufizuar

Konkurruese me negociata

Kuotim i çmimit

#### III.2) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

**III.2.1) Data e publikimit të njoftimit origjinal të kontratës:**

### NENI IV: INFORMACIONET PLOTËSUESE

#### IV.1) KY NJOFTIM PERFSHINE

Përmirësim

Informata shtesë

Njoftim për kontrate

Njoftim për dhënie kontrate

**IV.2) INFORMACIONI QE DUHET TE PERMIRESOHER OSE TE SHTOHET** (nëse aplikohet; te specifikohet vendi i tekstit ose datat te cilat duhet te përmirësohen apo te shtohen, ju lutem gjithmonë ofroni nenet përkatëse & numrin e paragrafit te njoftimit origjinal)

**IV.2.1) Modifikimi i informatave**   
origjinale të dorëzuara nga  
Autoriteti Kontraktues

Publikimi në webfaqen e KRPP-së   
nuk është në përputhje me informatat  
origjinale të dorëzuara nga Autoriteti  
Kontraktues

Të dyja

**IV.2.2) Në njoftimin origjinal**

Në dokumentet e tenderit

Të dyja

**IV.2.3) Teksti i cili duhet të përmirësohet/shtohet në njoftimin origjinal** (nëse aplikohet)

Vendi i tekstit i cili duhet të  
modifikohet:

Në vend të:

Është :

**Data e fillimi të kontratës:\***

30.10.2024

06.11.2024

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për sqarimin e dosjes së tenderit:	16.10.2024	23.10.2024
Afati i fundit për pranimit të tenderëve	23.10.2024 13:30:00	30.10.2024 13:30:00
Takimi për hapjen e tenderëve	23.10.2024 13:30:00	30.10.2024 13:30:00
Kërkesat e përshtatshmërisë		1) Deklarata nën betim se Operatori Ekonomik I plotëson kushtet në bazë të nenit 65 Paragrafi 65.1 pikat 1.1; 1.2; 1.3 të LPP-s, 1) Deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe e vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin-2 të dosjes së tenderit
Kërkesat e përshtatshmërisë		2) Operatori ekonomik duhet të ofroj një dokument të lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit që vërteton se operatori ekonomik i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë të nenit 65 të LPP-së paragrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4, 2) Një vërtetim i lëshuar nga Gjykata kompetente-(kopje). Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të njoftimit B 58 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe nuk duhet të jete me I vjetër se 180 ditë nga data e lëshimit deri në datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë. - Dështimi në dorëzimin të dokumenteve të tilla, tenderi I tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në nendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi I tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.
Kërkesat e përshtatshmërisë		3) Operatori ekonomik nuk

	<p>duhet të jetë delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit., 3) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik-(Kopje). Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të njoftimit B 58 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe nuk duhet të jete me I vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit deri në datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë. - Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla,tenderi I tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në nendin e dytë,si dhe do të konfiskohet sigurimi I tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicoj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.</p>
Përshtatshmëria profesionale	<p>1. Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin përkatës profesional, të bizneseve dhe ose të korporatave, 1. Kopja e Certifikatës së biznesit së bashku me pjesët informative të biznesit.</p>
Përshtatshmëria profesionale	<p>2. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jenë deklarues të TVSH-së, 2. Kopja e certifikatës së TVSH-së të lëshuar nga Organi Kompetent</p>
Përshtatshmëria profesionale	<p>3. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë regjistruar numrin fiskal në ATK, 3. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të numrit fiskal (nëse nuk është i përfshirë në certifikatën e biznesit)</p>
Përshtatshmëria profesionale	<p>4. Certifikat -ISO 9001-2015 - Sistemi i menaxhimit të cilësisë, 4.Certifikat ISO 9001-2015-Kopje në emër të Operatorit Ekonomik-Me</p>

	<b>vlefshmëri</b>
<b>Përshtatshmëria profesionale</b>	<b>5.Certifikat ISO 14001-2015 për menaxhimin e mjedisit, 5.Certifikat ISO 14001-2015 Kopje në emër të Operatorit Ekonomik-Me vlefshmëri</b>
<b>Përshtatshmëria profesionale</b>	<b>6.Certifikat ISO 45001-2018 për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, 6.Certifikat ISO 45001-2018 Kopje në emër të Operatorit Ekonomik-Me vlefshmëri</b>
<b>Kapaciteti ekonomik dhe financiar</b>	<b>Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor gjatë 3 viteve të fundit (2021,2022,2023) ka qenë jo më pak se (400,000.00€), Raportin,raportet apo vërtetimet përkatëse nga një ose më shumë banka ose deklaratat vjetore ne ATK me të cilat dëshmohet se O.E ka pasur një qarkullim financiar në tri vitet e fundit sipas kërkesës së lartshënuar</b>
<b>Kapaciteti teknik dhe profesional</b>	<b>1. Kontrata të përfunduara me sukses, jo më pak se (300,000.00 €) të lëmisë së ngjashme (Ndërtim,Rekonstruim,asfaltim të rrugëve) të këkuara në periudhën e shkuar tre vjeçare nga data e publikimit me njoftim per kontratë., 1.Listën e kontratave të lëmis se ngjashme- (Ndërtim,Rekonstruim,asfaltim të rrugëve),ku duhet saktësuar - Titullin e projektit,datën e nënshkrimit të kontratës,datën përfundimit të kontratës,shumën dhe përfituesi i projektit. Listës ti bashkangjitet- Kontratat,referencat ose procesverbalet e pranimit te punëve te përfunduara me sukses të natyrës së kërkuar ne tri vitet fundit, valide që janë deri me datën e njoftimit për kontratë.</b>
<b>Kapaciteti teknik dhe profesional</b>	<b>2.Menaxheri i projektit - Inxhinier i diplomuar I Ndërtimtarisë -Drejtimi Konstruktiv ose Arkitekturë</b>

	<p>(master ose inxhinier I diplomuar). Minimum 2 vite përvojë pune pas diplomimit.,  2.Kopja e diplomës përkatëse e noterizuar në vitin 2024 nën prezencën e inxhinjerit, CV-ja ,kontrata valide me Operatorin Ekonomik,ose marrëveshje bashkëpunimi me këtë projekt e nënshkruar nga të dyja palët. Dekleratë mbi menaxherin e projektit.Dëshmi mbi përvojën e punës pas diplomimit ( Minimum 2 vite).</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional	<p>3.Gjeodeti diplomuar (Baqelor ose inxhinjer i diplomuar i gjeodezise) i licencuar nga Agjencia Kadastrale e Kosoves.Minimum 2 vite përvojë pune pas diplomimit.,  3.Për gjeodetin Diploma e noterizuar në vitin 2024 nën prezencën e gjeodetit-Kopje e noterizuar ) si dhe licenca e lëshuar nga AKK e pa skaduar (Kopje), kontrata e punes valide me Operatorin Ekonomik,apo marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt e nënshkruar nga të dy palët.Dëshmi mbi përvojën e punës pas diplomimit ( Minimum 2 vite).</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional	<p>4.Bazë për prodhimin e asfaltit e licencuar, në pronesi apo marrëveshje për furnizim me asfalt me nje OE të licencuar,  4.Licenca valide për prodhim asfalti e leshuar nga Organet kompetente-Kopje, apo marrëveshje bashkëpunimi me Operatorin Ekonomik qe posedon bazë per prodhim asfalti (Marëveshja e nenshkruar dhe e vulosur nga te dy palet per realizimin e ketij projekti).</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional	<p>5.Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit •a) Eskavator me peshë min. (10 tonë deri me 26 tonë) -2 copë; •b) Ngarkues për hapje të rrugës- 2 copë; •c) Greder - 2 copë; •d)</p>

	<p><b>Kamion vetëshkarkues (kipër) me kapacitet min. 10 m<sup>3</sup> - 3copë; •e) Cilindër me rrota për ngjeshje të asfaltit - 2copë; •f) Finisher për shtrirjen e asfaltit - 2copë;</b></p> <p><b>5.Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar e nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik - Kopje.Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmoen me librezën e regjistrimit valide , ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj). Vërejtje! Në rast se Operatori Ekonomik nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate, e nënshkruar nga te dyja palët.</b></p>

----- (Shto nenin IV.2.3 sa here qe keni nevoje) -----